



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

VENDIM

Nr. 197, datë 26.04.2023

**PËR
TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM TË KANCELARIT TË GJYKATËS SË RRETHIT
GJYQËSOR PËRMET**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, nenit 80, nenit 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 557, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për krijimin, kompetencat dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit”, Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nr.42, datë 30.03.2023 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë”, Vendimit të KLGJ nr. 165, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet”,

VENDOSI:

1. Znj. {...}, ruan statusin e kancelares në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin e Shefes së Sektorit, Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimit, Protokoll/Arkiv, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë në datën 01.05.2023.
3. Njoftimin e këtij vendimi Znj. {...} dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR